



Prishtinë, 12.11 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1319_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitën e Nenit 16, paragrafi 1.41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085),
- Nenin 16 të licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KOSTT të datës 04 nëntor 2020 për aprovimin e dokumenteve:
 - o *Rregullat e harmonizuara afatgjata për Alokimin e të drejtave të transmetimit,*
 - o *Rregullat për alokimin ditor eksplicit për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO, dhe*
 - o *Shtojca specifike për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO për rregullat e harmonizuara afatgjata të alokimit;*

në seancën e mbajtur me 12 nëntor 2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet dokumenti *Rregullat e harmonizuara afatgjata për Alokimin e të drejtave të transmetimit;***
- II. **Aprovohet dokumenti *Rregullat për alokimin ditor eksplicit për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO;***
- III **Aprovohet dokumenti *Shtojca specifike për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO për rregullat e harmonizuara afatgjata të alokimit;***



Arsyetim

ZRRE në vitin 2014 ka aprovuar dokumentin *Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL nga SEE CAO*, dhe pastaj ka aprovuar amendamentimin e dokumentit në 2016. Dokumenti paraprakisht është miratuar nga Ekipi i Projektit të Kompanisë për Zyrën e Koordinuar të Ankandit të Evropës Juglindore (PTC CAO SEE - *Project Team Company Coordinated Auction Office in the South East Europe*).

Me zhvillimet e mëvonshme vendet anëtare të SEE CAO kanë aprovuar dhe adoptuar dokumentin e përgatitur nga ACER *Rregullat e harmonizuara afatgjata për Alokimin e të drejtave të transmetimit (Harmonised allocation rules for long-term transmission rights)* si dhe dokumentet *Rregullat për alokimin ditor eksplicit për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO* dhe *Shtojca specifike për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO për rregullat e harmonizuara afatgjata të alokimit*, por meqenëse KOSTT nuk ka operuar si zonë rregulluese nuk e ka pasur të mundur të bëjë alokimin e kapaciteteve interkonektive, pra nuk ka marrë shërbimet nga SEE CAO, andaj nuk ka kërkuar aprovimin nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të rregullave.

Pas zhvillimeve të fundit, pritet që KOSTT së shpejti të filloi të bëjë alokimin e kapaciteteve Interkonektive, andaj do të nevojitet edhe shfrytëzimi i shërbimit nga SEE CAO. Për të realizuar pranimin e këtij shërbimi, kërkohet aprovimi nga Rregullatori i dokumenteve që rregullojnë këtë aktivitet, kështu që me datë 04 nëntor 2020 ZRRE ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e dokumenteve *"Rregullat e harmonizuara afatgjata të Alokimit për të drejtat e transmetimit"*, *"Rregullat për alokimin ditor eksplicit për zona ofertuese shërbyer nga SEE"*, dhe *"Shtojca specifike për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO për rregullat e harmonizuara afatgjata të alokimit"*.

Pas shqyrtimit të dokumenteve, si dhe kërkesës së KOSTT për kryerjen e aktivitetit të ankandit për alokimin e kapaciteteve nga SEE CAO, ZRRE ka parë të arsyeshme që të **Aprovohen dokumentet *Rregullat e harmonizuara afatgjata të Alokimit për të drejtat e transmetimit, Rregullat për alokimin ditor eksplicit për zona ofertuese shërbyer nga SEE*, si dhe *Shtojca specifike për zona ofertuese shërbyer nga SEE CAO për rregullat e harmonizuara afatgjata të alokimit*.**

Hyrja në fuqi e këtyre dokumenteve shfuqizon dokumentin *Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL ver. 1.4* të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 03.10.2016.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi dhe dokumentet iu dërgohen:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bordi i ZRRE-së;



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar